



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.12

Tetor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

**I. Mbledhje e Këshillit të  
Ministrave e datës  
21.09.2004**

*PROJEKTLIGJE*

**(Vendime për propozime  
projektligjesh)**

1. Për ratifikim e Marrëveshjes së Garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), dhe të Marrëveshjes së Kredisë, ndërmjet Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e prodhimit të Energjisë termike në Vlorë.

2. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit, "Ndërtim, i segmentit rrugor Lushnjë – Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet rrugore, Lushnjë – Fier dhe Fier – Vlorë".

*(Vijon në faqen 2)*

## Nga Punimet e Kuvendit

**1. P/ligji "Për disa shtesa  
dhe ndryshime në ligjin  
nr.7895, datë 27.1.1995  
"Kodi Penal i Republikës së  
Shqipërisë", të ndryshuar  
(miratuar në seancë plenare  
më datë 16 shtator 2004)**

Projektligji synon të plotësojë e të përmirësojë dispozitat ekzistuese të Kodit Penal, në kuadër të masave legjislative për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombe të. Një nga dispozitat më të rëndësishme të projektligjit është dispozita që ndryshon nenin 28 të Kodit Penal, që parashikon elementët thelbësorë të formave të posaçme të bashkëpunimit kriminal, siç janë organizatat kriminale, organizatat terroriste, bandat e armatosura ose grupet e organizuara kriminale. Ai përcakton llojet dhe masat e dënimit për këto forma të krimit.

*(Vijon në faqen 4)*

**Në këtë numër  
do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e  
Këshillit të Ministrave  
faqe 1-3**

**2. Informacion mbi faqet  
e internetit të  
Institucioneve Qëndrore  
faqe 1**

**4. Nga punimet e  
Kuvendit për periudhën  
16-30 shtator 2004  
faqe 1,4**

**5. Kalendari 2 javor i  
Kuvendit,  
20 - 30 korrik 2004  
faqe 5-7**

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Presidenca  
[www.president.al](http://www.president.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e  
Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor  
dhe Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe  
Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1. Për shndërrimin e shkollës së lartë të infermierisë në Tiranë në Fakultet të Infermierisë, në varësi të Universitetit të Tiranës.
2. Për trajtimin e punonjësve, që dalin të papunë, si pasojë e rishtrukturimit të shoqërisë "TRANSNAFTA" shpk, Patos.
3. Për një shtesë në vendimin nr. 370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Selisë së NATO-s, Bruksel", të ndryshuar.
4. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit italian, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për asistencë teknike për programin e strategjisë së privatizimit.
5. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për përbalimin e shpenzimeve për takimin e ministrave të Drejtësisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
6. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "BOO", për ndërtimin e hidrocentralit të Bratilës, sipas propozimit të pakërkuar.
7. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), si administratore e fondeve të grantit japonez, për përgatitjen e projektit të sekuestrimit të karbonit me mbështetjen e komunitetit.
8. Për miratimin e listave të inventarit dhe transferimin në pronësi të bashkive dhe komuneve, të disa pronave të paluajtshme, që do të përdoren për ngritjen e qendrave të shërbimeve sociale.
9. Për lejimin e Ministrisë së Rendit Publik të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerjen e materialeve të zhytjes për raportin RENE A.
10. Për dhënie fondi Partisë Lëvizja Elitare Kombëtare.

11. Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2004, miratim për ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të zotit Ahmet Hoxhallari.
12. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të zyrës së përbarimit Kurbin, nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, drejtorisë së Përgjithëshme të Përbarimit në Ministrinë e Drejtësisë.
13. Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Rumanisë, për nxitjen dhe mbrotjen e ndërsjellë të investimeve.
14. Për emërim në detyrë.
15. Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësjellësve ndaj KESH sha-së, për tremujorin e tretë, të vitit 2004.

## **II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 30.9.2004** *PROJEKTLIGJE*

### **(Projektvendime për propozime projektligjesh)**

1. Për disa ndryshime në ligjin nr.9165, datë 23.12.2003 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2004", të ndryshuar.  
- Me këtë projektligj kërkohet që në ligjin e buxhetit të viti 2004, të bëhen disa ndryshime në kolononën për numrin e punonjësve në Prokurorinë e Përgjithëshme, Zyrën e Administrimit të Pushtetit gjyqësor dhe në Autoritetin e konkurrencës.
2. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare "Për asistencë të ndërsjellë administrative në çështjet doganore".  
- Shqipëria është autore me të drejta të plota në OBD (Organizata Botërore e Doganave) që nga viti 1992. Konventa synon t'i përgjigjet interesit në rritje të shteteve anëtare për një luftë globale ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit. Gjithashtu Konventa siguron bazë ligjore për shkëmbim informacioni dhe asistencë administrative ku përfshihen hetime të përbashkëta, shkëmbim ekspertësh e teknikësh, etj.

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1. Për miratimin e programit buxhetorafatmesëm, 2005-2007.
2. Për miratimin e letrës së politikave të zhvillimit, për kredinë e tretë, në mbështetje të uljes së varfërisë. (PRSC3).
3. Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik.
4. Për miratimin e dokumentit dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
5. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "BOO", për ndërtimin e hidrocentralit të Helmësit në rrethin e Kolonjës.
6. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për ndërtim e Zhvillim, për përgatitjen e projektit "Laguna e Karavastasë - Ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm".
7. Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Export – Inport të Koresë, për projektin e elektrifikimit të zonave rurale.
8. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale (MCC, S.p.A), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë – Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë–Fier dhe Fier–Vlorë.
9. Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të bashkuara të Amerikës, për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive të caktuara kulturore.
10. Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

*(Vijon në faqen 3)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

qeverisë së Republikës së Kroacisë, për stërvitjen “Adriatic Phib-Lex 04-6” (Adriatic Shield 04).

11. Për lejimin e ndërmarrjes eksport – import “Meico”, Tiranë të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për blerjen e pjesëve të këmbimit për helikopterët AB 205 dhe AB 2006, të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2004.

12. Për disa ndryshime në vendimin nr. 653, datë 25.9.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursta e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve”.

13. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimin nga Statusi i të Verbërit”, të ndryshuar.

14. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar.

15. Për një ndryshim në vendimin nr. 64, datë 29.1.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gajtë vitit 2004”.

16. Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.

17. Për kalimin e disa mjediseve të ëish-vendkomandës së kohës së veçantë, në qytetin e Vlorës, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave.

18. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Durrësit.

19. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Bubullimë.

20. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Kukësit.

21. Për financimin e shpenzimeve për festimin e 60 vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

22. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për

Kryeministrinë, për përballimin e shpenzimeve emergjente.

23. Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë jopublike “Marubi”.

24. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të kryejë procedurat e prokurimit, për realizimin e objektit public “Rikonstruksioni i segmentit rrugor Ura e Dajlanit-Plepa”.

## III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 8.10. 2004 PROJEKTLIGJE

### (Projektvendime për propozime projektligjesh)

1. Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

- Projektligji ka për objekt përcaktimin e një tërësie rregullash veprimi lidhur me të drejtat dhe detyrime e subjekteve pjesëmarrëse që mund të jenë persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj që ushtrojnë veprimtari krijuese, prodhuese, tregtare, si dhe çdo mënyrë tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi ose tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të buri-  
meve ujore.

- Marrëveshja është nënshkruar më 29.07.2004 për shumën 10.2 milion SDR, dhe është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.325, datë 21.5.2004.  
**VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1. Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtëshme, që preken nga sistemimi e ndërtimi i rrugës “Ibrahim Dincji” në bashkinë e Elbasanit.

2. Për shpronësimin për interes publik të pasurisë të paluajtëshme, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në bashkinë e Përrenjasit.

3. Për miratimin në parim të dokumentit për ndryshimin e marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave

të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Reforma në Arsim”, kredia 3343 ALB.

4. Për një ndryshim në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Kuçovës.

6. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, për vazhdimin e financimit të projektit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtëshme.

7. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për bashkinë e Bajram Currit, për zëvendësimin e vlerave monetare të grabitura.

8. Për lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor të Përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për rehabilitimin e mjediseve të fjetores në repartin “Renea”, Tiranë, për Gjykatën e Krimeve të rënda.

9. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për vazhdimin e punimeve të ndërtimit në segmentin rrugor Milot – Rrëshen, pjesë e aksit rrugor Durrës – Kukës – Morinë.

10. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të përdorë procedurën e prokurimit “Kërkesë për kuotim” për rikonstruksionin e segmentit rrugor Ura e Dajlanit-Plepa, Loti I.

11. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të përdorë procedurën e prokurimit “Kërkesë për kuotim” për rikonstruksionin e segmentit rrugor Ura e Dajlanit-Plepa, Loti II.

12. Për lirim dhe emërim në detyrë.

**TË NDRYSHME**  
Informacion: Për takimin e nëntë të grupit Konsultativ Tash – Forc BE – Sqipëri, që do të zhvillohet në Tiranë, më datën 22 Tetor 2004.



# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 SHTATOR 2004

*(Vijon nga faqja 1)*

Ndryshime të rëndësishme në këtë projektligj janë bërë në dispozitat që lidhen me korrupsionin e ushtruar nga funksionarët publikë ose në sektorin privat, të cilat shoqërohen me sanksionet përkatëse. Kuvendi shqyrtoi e miratoi propozimet e paraqitura nga Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve dhe disa propozime të deputetëve për plotësimin, saktësimin ose ndryshimin e disa dispozitave të Kodit Penal.

## **2. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (miratuar në seancë plenare më datë 16 shtator 2004)**

Ky projektligj synon të përmirësojë disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale, veçanërisht dispozitat që kanë të bëjnë me teknikat e hetimit dhe rregullat e shqyrtimit gjyqësor, vendos rregulla për procedurat e bashkëpunimit me drejtësinë, përcakton rregulla për mënyrën e marrjes në pyetje të të pandehurve, dëshmitarëve dhe ekspertëve në distancë dhe për mënyrën e pyetjes së bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Gjithashtu, ai vendos rregulla për organizimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda, si përbërjen e trupit gjykues të këtyre gjykatave, procedurat e gjyqimit në themel të çështjeve dhe të kërkesave paraprake dhe llojin e veprave penale që janë në kompetencë të tyre. Gjatë diskutimit të projektligjit Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi disa propozime kryesisht të karakterit redaktorial të paraqitura nga Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, me synim përmirësimin e përmbajtjes së tij.

## **3. P/ligji “Për sigurinë në anije dhe porte” (miratuar në seancë plenare më datë 23 shtator 2004)**

Projektligji ka si qëllim të garantojë sigurinë në anije dhe porte, si dhe të parandalojë aktet terroriste, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga aktet juridike kombëtare dhe nga aderimi i vendit tonë në konventat ndërkombëtare. Objekti i tij është ngritja e një force sigurie në port, si dhe përcaktimi i strukturës së organizimit e rregullave, në bazë të të cilave do të veprojë kjo forcë në bashkëpunim me organet shtetërore dhe ato të përfaqësimit në porte.

Komisionet e përhershme të Kuvendit, veçanërisht Komisioni për Rendin dhe SHISH-in, i paraqitën Kuvendit disa propozime për riformulimin e disa dispozitave të tij. Këto propozime u miratuan nga Kuvendi.

Konkretisht, Kuvendi miratoi propozimin për riformulimin e nenit 26, pika 2 të projektligjit, i cili përcakton më saktë se cilat janë autoritetet ligjore për dhënien dhe kontrollin e lejes shtetërore në rastin e transportimit ose mbajtjes së armëve,

municioneve, substancave kimike, biologjike dhe helmuese në port, anije ose në zonën e sigurisë së portit. Kuvendi miratoi edhe propozimin për riformulimin e nenit 27, pika 5/b, i cili saktëson procedurat që duhet të ndjekë personi i autorizuar, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, në rastet kur ka arësye të mjaftueshme për të besuar se sendi i kapur në anije ose në zonën e sigurisë së portit përbën rrezik për sigurinë.

Gjithashtu, Kuvendi miratoi edhe disa saktësime në procedurat që ndiqen në rastet kur subjektet refuzojnë kontrollin e tyre ose të bagazhit, procedurat që ndiqen për personat që kanë shkelur dispozitat ligjore në port ose në zonat e sigurisë në porte, procedurat që ndiqen për lejimin e personit të autorizuar të hyjë në mjediset e ekuipazhit ose të pasagjerëve etj.

## **4. P/ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar” (miratuar në seancë plenare më datë 30 shtator 2004)**

Projektligji synon të parandalojë dhe të godasë krimin e organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në këtë veprimtari. Ai përcakton detyrat, procedurat dhe kriteret që duhet të zbatohen për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe terrorizmin, si dhe në disa forma të tjera të rënda të veprimtarisë kriminale si trafiqet, rrëmbimi i personit etj. Element shumë i rëndësishëm i projektligjit është se ai merr përsipër të krijojë institucionet e specializuara që do të merren me trajtimin, administrimin dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare u propozuan e miratuan disa ndryshime që synojnë të përmirësojnë përmbajtjen e tij. Një ndër propozimet që u diskutua e miratua ka të bëjë me nenin 3 të projektligjit dhe synon të saktësojë ligjërisht rrethin e personave të dyshuar, mbi të cilët zbatohen dispozitat e këtij ligji e konkretisht, rrethin e personave të afërt me personat që kanë marrë pjesë në organizata kriminale, organizata terroriste ose që kanë kryer krime për qëllime terroriste ose krime të tjera të parashikuara në Kodin Penal.

Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi edhe propozimin e deputetëve për riformulimin e nenit 37 të projektligjit, i cili synon të ndryshojë përbërjen e Komitetit Këshillues për Masat kundër Krimin të Organizuar, duke hequr nga ky Komitet të gjithë titullarët e institucioneve të sistemit të drejtësisë, siç janë Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe të Apelit.

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (4-14 TETOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

***E Hënë, datë 4.10.2004, Ora 17.00***

***-Seancë Plenare***

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.

2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Spartak Braho nga Ministri i Shtetit për Kordinimin.

3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Valentin Palaj nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. Përgjigje e pyetjeve të deputetes Marjeta Zaçe nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

***E Martë, datë 5.10.2004***

***E Mërkurë, datë 6.10.2004***

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Koventën Ndërkombëtare "Për krijimin e Fondit Ndërkombëtar për kompensimin e dëmeve nga ndotja me karburant", 1992".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës***

***-Komisioni i Industrisë***

2. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për përgjegjësinë civile për

dëmet nga ndotjet me karburant, 1992".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni i Industrisë***

3. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen "Për Transportin Ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve me autobus" (Marrëveshja Interbus).

***-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni i Industrisë***

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, për ripranimin e personave, dhe të protokollit të saj".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Jashtëm***

***-Komisioni i Rendit***

5. P/Ligji "Për Verifikimin, Identifikimin dhe Regjistrimin e shtetasve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore" (paraqitur nga një grup deputetësh).

***-Komisioni i Ligjeve***

6. P/Ligji "Për Veterinarinë".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit (e ka shqyrtuar)***

7. P/Ligji "Mbi Dhomën e Mjekëve veterinarë dhe profesionin e mjekut veterinar" (paraqitur nga deputeti N. Alibali).

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit***

8. P/Ligji "Për legalizimin e zonave informale".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Industrisë (e ka shqyrtuar)***

***-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës***

***-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit***

9. P/Ligji "Për legalizimin e ndërtimeve në ngulimet e reja komunitare nëtur nga një grup deputetësh).

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës***

10. P/Ligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

***-Komisioni i Ligjeve***

***-Komisioni i Punës dhe Çështjeve (Vijon në faqen 6)***

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (4 - 14 TETOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 4)

### Sociale

#### -Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

11. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7697, datë 7.04.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

#### -Komisioni i Ligjeve

12. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit, të vitit 2003".

Raport i KLSH "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2003".

#### -Komisioni i Ligjeve

#### -Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

#### -Komisionet e tjera

13. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (paraqitur nga një grup deputetësh, si dhe p/ligji i paraqitur nga deputeti N. Alibali).

#### -Komisioni i Ligjeve

#### -Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

14. P/Ligji "Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak".

#### -Komisioni i Ligjeve

#### -Komisioni i Rendit dhe SHISH-it

#### -Komisioni i Mbrojtjes

15. Shqyrtimi i propozimeve për Këshillin Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë".

#### -Komisioni i Ligjeve

16. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

#### -Komisioni i Ligjeve

#### E Enjte, datë 7.10.2004, ora 10.00

#### -Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokolit shtesë të Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".

3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen "Për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe paisjet speciale, që përdoren në këto transporte".

4. P/Ligji "Për produktet e ndërtimit".

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për Këshillin Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë.

#### E Hënë, datë 11.10.2004, ora 17.00

#### -Seancë Plenare

1. Interpelancë me Kryeministrin, kërkuar nga Grupi Parlamentar i PR-së.

2. Interpelancë me Ministrin e Jashtëm, kërkuar nga deputetët Vangjel Tavo dhe Stefan Çipa.

#### E Martë, datë 12.10.2004

#### E Mërkurë, datë 13.10.2004

-Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për pranimin e personave".

#### -Komisioni i Ligjeve

#### -Komisioni i Jashtëm

#### -Komisioni i Rendit

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme".

#### -Komisioni i Ligjeve (Vijon në faqen 5)

# Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 6)

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Rendit**

3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Arsimit dhe Kulturës**

4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Shëndetësisë (e ka shqyrtuar)**

5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", i ndryshuar (paraqitur nga një grup deputetësh).

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Mbrojtjes**

**-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale**

6. P/Ligji "Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit" (paraqitur nga deputetët Nard Ndoka, Alfred Çako, Ilirjan Berzani).

**-Komisioni i Ligjeve**

7. P/Ligji "Për miratimin e strategjisë së sigurisë në Republikën e Shqipërisë"

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Mbrojtjes**

**-Komisioni i Rendit**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

**-Komisionet e tjera**

8. P/Ligji "Për disa masa në mbrojtje të mjedisit" (paraqitur nga deputetët Nard Ndoka dhe Ilirjan Berzani).

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

**-Komisioni i Shëndetësisë**

**E Enjte, datë 14.10.2004, ora 10.00**

**-Seancë Plenare**

1. P/Ligji "Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak".

2. P/Ligji "Për Verifikimin, Identifikimin dhe Regjistrimin e shtetasve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore".

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për Buxhetin Faktik të vitit 2003.

5. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit, të vitit 2003".

## Njoftim

**Të nderuar zonja e zotërinj,**  
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)



# KALENDAR I

## 2 JAVOR (4 - 14 TETOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 4)

-Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për pranimin e personave".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Rendit**

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psiko-trope dhe prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Rendit**

3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Arsimit dhe Kulturës**

4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Shëndetësisë (e ka shqyrtuar)**

5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", i ndryshuar (paraqitur nga një grup deputetësh).

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Mbrojtjes**

**-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale**

6. P/Ligji "Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit" (paraqitur nga deputetët Nard Ndoka, Alfred Çako, Ilirjan Berzani).

**-Komisioni i Ligjeve**

7. P/Ligji "Për miratimin e strategjisë së sigurisë në Republikën e Shqipërisë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm**

**-Komisioni i Mbrojtjes**

**-Komisioni i Rendit**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

**-Komisionet e tjera**

8. P/Ligji "Për disa masa në mbrojtje të mjedisit" (paraqitur nga deputetët Nard Ndoka dhe Ilirjan Berzani).

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

**-Komisioni i Shëndetësisë**

**E Enjte, datë 14.10.2004, ora 10.00**

**-Seancë Plenare**

1. P/Ligji "Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak".

2. P/Ligji "Për Verifikimin, Identifikimin dhe Regjistrimin e shtetasve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore".

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompenzimit të Pronave.

4. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për Buxhetin Faktik të vitit 2003.

5. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit, të vitit 2003".





## **II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 30.9.2004**

### *PROJEKTLIGJE*

#### **(Projektvendime për propozime projektligjesh)**

1. Për disa ndryshime në ligjin nr.9165, datë 23.12.2003 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2004”, të ndryshuar.

- Me këtë projektligj kërkohet që në ligjin e buxhetit të viti 2004, të bëhen disa ndryshime në kolononën për numrin e pnonjësve në Prokurorinë e Përgjithëshme, Zyrën e Administrimit të Pushtetit gjyqësor dhe në Autoritetin e konkurrencës.

2. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare “Për asistencë të ndërsjellë administrative në çështjet doganore”.

- Shqipëria është autore me të drejta të plota në OBD (Organizata Botërore e Doganave) që nga viti 1992. Konventa synon t'i përgjigjet interesit në rritje të shteteve anëtare për një luftë globale ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit. Gjithashtu Konventa siguron bazë ligjore për shkëmbim informacioni dhe asistencë administrative ku përfshihen hetime të përbashkëta, shkëmbim ekspertësh e teknikësh, etj.

#### **VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1. Për miratimin e programit buxhetorafatmesëm, 2005-2007.

2. Për miratimin e letrës së politikave të zhvillimit, për kredinë e tretë, në mbështetje të uljes së varfërisë. (PRSC3).

3. Për miratimin e dokumentit të politikave të decentralizimit në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

4. Për miratimin e dokumentit dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

5. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës “BOO”, për ndertimin e hidrocentralit të Helmësit në rrethin e Kolonjës.

6. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për ndërtim e Zhvillim, për përgatitjen e projektit “Laguna e Karavastasë - Ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm”.

7. Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Export – Inport të Koresë, për projektin e elektrikimit të zonave rurale.

8. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale (MCC, S.p.A), për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnjë – Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë–Fier dhe Fier–Vlorë.

9. Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të bashkuara të Amerikës, për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive të caktuara kulturore.

10. Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë, për stërvitjen “Adriatic PhibLex 04-6” (Adriatic Shield 04).

11. Për lejimin e ndërmarrjes eksport – import “Meico”, Ti-

ranë të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për blerjen e pjesëve të këmbimit për helikopterët AB 205 dhe AB 2006, të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2004.

12. Për disa ndryshime në vendimin nr. 653, datë 25.9.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursta e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve”.

13. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimin nga Statusi i të Verbërit”, të ndryshuar.

14. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar.

15. Për një ndryshim në vendimin nr. 64, datë 29.1.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gajtë vitit 2004”.

16. Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.

17. Për kalimin e disa mjediseve të ëish-vendkomandës së kohës së veçantë, në qytetin e Vlorës, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave.

18. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Durrësit.

19. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Bubullimë.

20. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Kukësit.

21. Për financimin e shpenzimeve për festimin e 60 vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

22. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Kryeministrinë, për përballimin e shpenzimeve emergjente.

23. Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë jopublike "Marubi".

24. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të kryejë procedurat e prokurimit, për realizimin e objektit public "Rikonstruksioni i segmentit rrugor Ura e Dajlanit- Plepa".

### **III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 8.10.2004**

#### *PROJEKTLIGJE*

#### **(Projektvendime për propozime projektligjesh)**

1. Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

- Projektligji ka për objekt përcaktimin e një tërësie rregullash veprimi lidhur me të drejtat dhe detyrime e subjekteve pjesëmarrëse që mund të jenë persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj që ushtrojnë veprimtari krijuese, prodhuese, tregtare, si dhe çdo mënyrë tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi ose tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

(IDA), për projektin e menaxhimit të burimeve ujore.

- Marrëveshja është nënshkruar më 29.07.2004 për shumën 10.2 milion SDR, dhe është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.325, datë 21.5.2004.

#### **VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1. Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtëshme, që preken nga sistemi i ndërtimi i rrugës "Ibrahim Dinçi" në bashkinë e Elbasanit.

2. Për shpronësimin për interes public të pasurisë të paluajtëshme, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në bashkinë e Përrenjasit.

3. Për miratimin në parim të dokumentit për ndryshimin e marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit "Reforma në Arsim", kredia 3343 ALB.

4. Për një ndryshim në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

5. Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Kuçovës.

6. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, për vazhdimin e financimit të projektit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtëshme.

7. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për bashkinë e Bajram Currit, për

zëvendësimin e vlerave monetare të grabitura.

8. Për lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor të Përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për rehabilitimin e mjediseve të fjetores në repartin "Renea", Tiranë, për Gjykatën e Krimeve të rënda.

9. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të Përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për vazhdimin e punimeve të ndërtimit në segmentin rrugor Milot – Rrëshen, pjesë e aksit rrugor Durrës – Kukës – Morinë.

10. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të përdorë procedurën e prokurimit "Kërkesë për kuotim" për rikonstruksionin e segmentit rrugor Ura e Dajlanit-Plepa, Loti I.

11. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të përdorë procedurën e prokurimit "Kërkesë për kuotim" për rikonstruksionin e segmentit rrugor Ura e Dajlanit-Plepa, Loti II.

12. Për lirim dhe emërim në detyrë.

#### **TË NDRYSHME**

Informacion: Për takimin e nëntë të grupit Konsultativ Tash – Forc BE – Sqipëri, që do të zhvillohet në Tiranë, më datën 22 Tetor 2004.